

RREGULLAT DHE PROCEDURAT E KONKURSIT

**“GJYQI SIMULUES I
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT - SHQIPËRI 2015”**

II

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i konkursit

Konkursi konsiston në zgjidhjen e një rasti fiktiv (kazu) ku janë shkelur të drejtat e njeriut, bazuar në rregullat dhe procedurat e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rregulloren e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ekipet pjesëmarrëse në konkursin “Gjyqi Simulues i GJEDNJ - Shqipëri II” do të duhet të zbatojnë rregullat si më poshtë vijon, gjatë fazës me shkrim të konkursit, si edhe fazës gjysëm finale e finale në rast kualifikimi.

TITULLI I - ORGANIZIMI I KONKURSIT

Neni 2

Këshilli Shkencor

Në kuadër të cilësisë shkencore të të gjithë konkursit, Këshilli Shkencor ka funksion të krijojë dhe redaktojë kazusin praktik, t'i përgjigjet pyetjeve të pjesëmarrësve, të krijojë panelin e gjyqtarëve, të kujdeset që renditja të jetë e saktë, si edhe të procedojë me kërkesat dhe kontestimet e pjesëmarrësve.

Neni 3

Gjuha e konkursit

Paraqitja e argumentave me shkrim, si edhe prezantimi verbal në fazat e tjera do të zhvillohen në gjuhën shqipe, gjuhë zyrtare e konkursit.

Neni 4

Vendi ku do të zhvillohet konkursi

Faza gjysëm finale dhe finale e konkursit do të zhvillohen në Tiranë pranë ambienteve të dy prej Gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

TITULLI II - PJESMARRJA NË KONKURS

Neni 5

Ekipet

1. Ekipet pjesëmarrëse do të përbëhen nga 7 persona, ku 6 prej tyre do të jenë studentë të fakulteteve pjesëmarrëse dhe anëtari tjetër do të jetë lideri i ekipit. Lideri i ekipit do të ketë mundësi të instruktojë dhe këshillojë studentët, vetëm gjatë fazës me shkrim. Çdo anëtar, pjesë përbërëse e grupit me 6 studentë, duhet të jetë pjesë aktive gjatë prezantimit të argumentave me gojë.
2. Një universitet mund të përfaqësohet vetëm me një ekip dhe anëtarët pjesëmarrës duhet të jenë të ndryshëm nga ata të vitit të kaluar.

Neni 6

E drejta e pjesëmarrjes

Çdo ekip pjesëmarrës i nënshtrohet rregullave të miratuara nga Këshilli Shkencor për konkursin, të cilat janë të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 7

Koordinimi logjistik

Organizatorët e konkursit “Gjyqi Simulues i GJEDNJ - Shqipëri II” do të kujdesen për transportin dhe akomodimin e pjesëmarrësve gjatë fazës gjysëm finale dhe finale të konkursit.

PJESA II

RREGULLAT

Neni 8

Rregullat e konkursit

1. Konkursi do të përbëhet nga faza me shkrim dhe faza me gojë. Procedura e konkursit do të bazohet në procedurën e aplikuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
 2. Faza e parë e konkursit do të jetë faza me shkrim. Kjo fazë konsiston në përgatitjen nga secili ekip i argumentave me shkrim mbi kazusin e dhënë në mbrojtje të interesave të Kërkuessit, po ashtu edhe të palës tjetër, pra të interesave të Shtetit. Pas dorëzimit të
-

argumenteve me shkrim, Këshilli Shkencor do të përzgjedhë 6 ekipet më të mira në bazë të kriterëve të mirëpërcaktuara, të cilët do të marrin pjesë në gjysëm-finale.

3. Këto 6 ekipe do të ndahen me short në 2 grupe nga 3 ekipe përfaqësuese secili, ku 3 ekipe do të përfaqësojnë *Kërkuesin* dhe 3 ekipe *Shtetin*. Paneli i gjyqtarëve, përballë të cilit do të prezantojnë ekipet, bazuar në pikët që do të grumbullojë secili në argumentet me gojë, duke marrë parasysh në rast barazimi dhe rezultatet e pikëve me shkrim, do të përzgjedhë dy ekipet më të mira, nga një për secilin grup (*Kërkuesi* dhe *Shteti*).

4. Ekipi më i mirë i grupit “*Kërkuesi*” do të përballet në finale me ekipin më të mirë të grupit “*Shteti*”.

Neni 9

Kazusi

1. Kazusi do të hartohet dhe shkruhet nga Këshilli Shkencor. Ai do të vendoset në dispozicion të ekipeve pjesëmarrëse në një datë të caktuar po nga Këshilli Shkencor.

2. Nuk do të lejohet ri-përdorja e të njëjtit rast praktik pa autorizimin e organizatorëve të konkursit “Gjyqi Simulues i GJEDNJ - Shqipëri II”.

Neni 10

Pyetjet

1. Ekipet pjesëmarrëse në konkurs mund t’i drejtohen Këshillit Shkencor për paqartësitë, që mund të ndeshin në paraqitjen e fakteve të rastit praktik. Pyetjet sqaruese do të dërgohen vetëm përmes postës elektronike, në një adresë të veçantë dedikuar konkursit.¹

2. Çdo ekip mund të bëjë maksimalisht deri në 5 pyetje mbi paraqitjen e fakteve. Në hartimin e pyetjes do të duhet të specifikohet numri i paragrafit, që është i paqartë në kazusin praktik dhe pyetja në lidhje me këtë paragraf.

3. Këshillit Shkencor i rezervohet e drejta të mos i përgjigjet pyetjeve, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejt me paraqitjen e fakteve, pyetjeve të cilat mund të krijojnë hapësira për kundërshtime gjatë fazave të konkursit.

4. Përgjigjet e pyetjeve do t’u vihen në dispozicion të gjithë ekipeve dhe do të dërgohen maksimumi 3 ditë pasi është drejtuar pyetja.

Neni 11

Përzgjedhja e përfaqësimit të Kërkuesit dhe Shtetit

1. Pasi të ketë përfunduar procedura e përzgjedhjes së skuadrave gjysëmfinaliste, një përfaqësues i Qendrës Evropiane do të procedojë me hedhjen e shortit, një natë përpara

¹ mootcourtechr@euro-centre.eu

fazës gjysëm finale në ceremoninë, që do të organizohet për këtë qëllim, për të identifikuar se cilat skuadra do të përfaqësojnë Kërkuesin dhe cilat Shtetin. Renditja e skuadrave do të bëhet në bazë të pikëve të fituara në fazën me shkrim.

2. Shorti se cilën palë do të përfaqësojë ekipi në finale do të hidhet në ambientet e Qendrës Evropiane.
3. Në ditën e zhvillimit të konkursit është rreptësisht e ndaluar, që skuadrat e tjera gjysëm-finaliste të jenë prezente në sallën e gjyqit gjatë zhvillimit të një raundi përballjeje mes dy skuadrave.

PJESA III

PËRMBAJTJA E PËRMBLEDHJEVE ME SHKRIM

TITULLI I - PËRMBLEDHJET

Neni 12

Redaktimi i përmbledhjeve

1. Secili ekip duhet të paraqesë argumentat me shkrim për të dyja palët (përfaqësuesit e Kërkuesit dhe përfaqësuesit e Shtetit) brenda afatit të caktuar nga Këshilli Shkencor i konkursit.
2. Çdo dosje duhet të jetë e formatuar sipas kriterëve të parashikuara nga kjo rregullore.
3. Secila përmbledhje duhet të përmbajë ekskluzivisht tre pjesë:

- Tabelën e përmbajtjes;
- Tekstin ku do të paraqiten argumentat;
- Aneksin bibliografik, i cili do të tregojë dokumentat, që janë përdorur në përgatitjen e materialeve.

Neni 13

Formati

1. Teksti kryesor i përmbledhjes nuk duhet të kalojë 20 faqe (1800 karaktere/faqe, shkrim 12 Times Neë Roman përfshi dhe hapësirat). Gjatësia e tekstit për përmbledhjen nuk do të kalojë 36.000 karakteret, përfshirë këtu dhe hapësirat.
2. Teksti duhet të përfshijë përmbledhjen e fakteve të çështjes, argumentat dhe referencat. Jashtë këtyre kufizimeve janë tabelat e përmbajtjes dhe bibliografia.
3. Referencat duhet të vendosen në fund të çdo faqeje. Një pyetje ose një argument, që nuk është parashtruar në tekstin kryesor të përmbledhjes, nuk do të lejohet të shtohet në pjesë të

tjera të përmbledhjes. Referencat në fund të tekstit kanë të bëjnë me referimin e burimeve ligjore të autoriteteve.

4. Teksti kryesor i përmbledhjes duhet të ketë hapësirën 1.5. Referencat dhe titujt mund të kenë një ndarje me hapësirë 1.

5. Marxhinat poshtë dhe lart duhet të jenë 3 cm dhe marxhinat e faqes majtas/djathtas duhet të jenë 2 cm.

6. Në rast mos zbatimi të këtyre rregullave teknike do të penalizohen me ulje pikësh.

Neni 14 Korrigjimet

Skuadrat nuk mund të rishikojnë, ndryshojnë, shtojnë ose heqin informacion nga përmbledhja e tyre me shkrim, pasi është bërë dorëzimi i materialit.

Neni 15 Afati

1. Argumentat me shkrim do të dërgohen brenda datës **23 nëntor 2015**, në adresën e e-mailit të konkursit (mootcourtechr@euro-centre.eu) në formatin “.pdf ose .doc”, si edhe në një zarf të mbyllur me postë në adresën: Qendra Evropiane, Rr. “V. Pasha”, P. 20/57, Tiranë-Shqipëri. Zarfë duhet të mbajë vulën postare të datës e cila do ju komunikohet përmes emailit zyrtar.

2. Skuadrat do të kenë në dispozicion jo më pak se 4 javë kohë për të përgatitur argumentet me shkrim.

Neni 16 Vlerësimi i përmbledhjes me shkrim

Përmbledhjet vlerësohen nga Këshilli Shkencor i konkursit. Pikët variojnë nga një kufi minimal prej 10 deri në kufirin maksimal prej 100 pikësh, të ndarë 90 pikë përmbajtja dhe 10 forma.

Faktorët që do të merren në konsideratë për dhënien e pikëve, mes të tjerash janë si më poshtë:

- Pretendimet e ngritura në bazë të neneve të Konventës;
- Njohuritë lidhur me analizën, thellimin, efektivitetin, aftësinë për të bindur dhe logjika;
- Argumentet ligjore;
- Pikëpamjet e ndryshme;
- Etika;
- Forma.

Në rastet kur do të paraqitet një kërkesë me shkrim nga një ekip pjesëmarrës relevanca dhe argumentimi i pikëve do të merret në konsideratë.

TITULLI II - RAUNDET VERBALE

Neni 17

Organizimi dhe procedura për raundet verbale

1. Raundet verbale përfshijnë raundet gjysëm finale dhe finalen e konkursit.
2. Raundet verbale do të hapen me parashtrimet që i referohen fakteve të çështjes së Kërkuesit dhe më pas parashtron argumentet pala e Shtetit. Koha limit e lejuar për secilën palë është 20 minuta.
3. Koha e përcaktuar për çdo ekip përfshin kohën për përgjigjet dhe prapësimet. Askush nuk mund të kalojë minutazhin, që është përcaktuar për çdo raund.
4. Gjyqtarët e panelit kanë të drejtë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime përfaqësuesve të ekipeve në çdo kohë. Pyetjet dhe përgjigjet do të llogariten 10 minuta për secilin ekip. Ekipet nuk mund të konsultohen me liderët e skuadrave gjatë përgatitjes së pyetjeve. Gjykata i jep skuadrave 5 minuta kohë të përgatiten.
5. Minutazhi do të kronometrohet nga asistenti i seancës, i cili do të ulet pranë panelit të gjyqtarëve.

Neni 18

Koha shtesë

1. Skuadra duhet të paraqesë kërkesën për kohën shtesë para asistentit të seancës dhe ky i fundit zgjat kohën shtesë deri në 5 minuta.
2. Paneli i gjyqtarëve mund t'u lejojë ekipeve kohë shtesë për të përmbyllur argumentet e tyre.

Neni 19

Regjistrimi i kohës

Asistenti i seancës ka përgjegjësinë për mbajtjen e minutazhit. Ai tregon kur kanë mbetur 10, 5 dhe 2 minuta nga koha e lejuar për çdo ekip dhe kur koha ka përfunduar.

Neni 20

Paneli i gjyqtarëve

1. Gjyqtarët e panelit caktohen nga Këshilli Shkencor.
 2. Gjyqtarët nuk mund të jenë persona të cilët kanë shoqëruar skuadrat ose i kanë ndihmuar ata në përgatitje.
 3. Emrat e gjyqtarëve do të mbahen në diskrecion absolut.
-

TITULLI III - DOKUMENTET DHE KONSULTIMET

Neni 21

Dokumentat dhe informacionet konfidenciale

Argumentet e paraqitura nga çdo ekip gjatë parashtrimeve me shkrim si dhe atyre verbale nuk duhet të kenë lidhje me çështje të cilat janë ende pezull pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të tilla do të konsiderohen informacione, që kanë karakteristikat e parashikuara në Protokollin 11 të Konventës Evropiane.

Neni 22

Konsultimet

Ndalohet në mënyrë kategorike konsultimi me gjyqtarë të GJEDNJ-së, Këshillit të Europës, si edhe anëtarë të Këshillit Shkencor të këtij konkursi.

Neni 23

Vlerësimi gjatë fazave verbale

1. Gjatë vlerësimit të argumentimit në fazat verbale çdo gjyqtar ka mundësi t'i japë maksimalisht 100 pikë skuadrave pjesëmarrëse. Rezultati final i pikëve për secilën skuadër do të jetë mesatarja e shumës së pikëve të të gjithë gjyqtarëve.
2. Në rast se dy skuadra dalin me rezultat të barabartë pikësh, pikët e marra në argumentet me shkrim janë ato që vendosin se cila do të jetë skuadra fituese.
3. Në fazën e argumentave me shkrim 50 (pesëdhjetë) pikë do të jenë për argumentimin, 25 (njëzetë e pesë) pikë për mënyrën e referimit, 15 (dhjetë) pikë respektimi i formatit të përcaktuar nga kjo rregullore dhe 10 (pesëmbëdhjetë) pikë për dorëzimin e dosjes në afatin e përcaktuar.
4. Për ekipet e kualifikuara në gjysëm-finale dhe në raundin final, shpërndarja e pikëve do të jetë: 50 (pesëdhjetë) pikë do të jenë për argumentimin, 25 (njëzetë e pesë) pikë për elokuencën, 10 (dhjetë) pikë respektimi i kohës dhe 15 (pesëmbëdhjetë) pikë për respektimin e etikës gjatë procesit gjyqësor.
5. Ekipet pjesëmarrëse në konkurs do të pajisen me çertifikata.

PJESA V ÇMIMI

Neni 24 Çmimi për ekipin fitues

1. Ekipi fitues në konkursin kombëtar “Gjyqi Simulues i GJEDNJ - Shqipëri II” do të ketë të drejtë të marrë pjesë në konkursin rajonal “Moot Court Competition” të organizuar nga Civil Rights Defenders në një shtet të rajonit.
2. Ekipi fitues i konkursit rajonal do të ndeshet me ekipin fitues të gjyqit simulues të vendeve nordike (Nordic Moot Court), i cili do të zhvillohet në Strasbourg, Francë pranë GJEDNJ-së. Gjuha e këtij konkursi do të jetë anglishtja.

PJESA VI

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 25 Kortezia

1. Pjesëmarrësit në konkurs janë të detyruar të zbatojnë etikën e komunikimit në lidhje me panelin e gjyqtarëve, me përfaqësuesit e ekipit kundërshtar, me Këshillin Shkencor, si edhe me organizatorët e konkursit.
2. Pjesëmarrësit në konkurs janë të detyruar t'i drejtohen panelit të gjyqtarëve me shprehjen “*Të nderuar gjyqtarë evropian*”, si edhe të bëjnë paraqitjen e argumentave të tyre duke qëndruar në këmbë.
3. Gjatë konkursit pjesëmarrësit duhet të respektojnë kodin serioz të veshjes.

Neni 26 Sanksionet

Mosrespektimi i kësaj rregulloreje do të jetë objekt sanksioni në proporcion me shkeljen e kryer. Vendimet e këtyre sanksioneve do të merren nga Këshilli Shkencor.

Neni 27 Data të rëndësishme

1. Faza gjysëm finale e konkursit do të organizohet më datë 5 dhjetor 2015. Skuadrat pjesëmarrëse do të njoftohen për vendin ku do të zhvillohen seancat.

2. Faza finale e konkursit do të organizohet më datë 19 dhjetor 2015. Skuadrat pjesëmarrëse do të njoftohen për vendin ku do të zhvillohen seancat.

Neni 28
Logjistika

1. Të gjithë pjesëmarrësit në konkurs duhet të marrin pjesë në ceremoninë e hapjes, që do të organizohet më datë 4 dhjetor 2015. Vendi do t'u komunikohet pjesëmarrësve nga stafi organizator.

2. Konkurentët do të kenë mundësinë të akomodohen të gjithë sëbashku në një ambient të përshtatshëm, në mënyrë që të nxitet sa më tepër fryma e bashkëpunimit mes skuadrave dhe puna në grup.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë nga nisja e konkursit “Gjyqi Simulues i GJEDNJ - Shqipëri II”.